VENDIM
Nr. 128, datë 28.2.2025

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PROJEKTEVE FITUESE TË FINANCUARA PËR VITIN 2025 NGA FONDI PËR DIGAT, SI DHE TË AUTORITETIT KONTRAKTOR PËR ZBATIMIN E PROJEKTEVE, SIPAS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 15, e të pikës 10, të aneksit 7, "Fondi për digat", të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së projekteve fituese të financuara për vitin 2025 nga fondi për digat, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 1
REHABILITIM – DIGA 2025

Nr.	Bashkia	Objekti (emërtimi i projektit)	Autoritet kontraktor	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Financimi për vitin 2025 (në lekë)
1	**Rrogozhinë**	Rikonstruksioni i digës së rezervuarit të Domes	**Bashkia**	**60,154,554**	**26,567,785**
2	**Lushnjë**	Rehabilitim i shkarkuesit në rezervuarin Kasharaj	**Bashkia**	**39,885,517**	**17,615,787**
3	**Dropull**	Rehabilitimi i Digës Pepel 1, Bashkia Dropull	**Bashkia**	**76,470,262**	**33,773,760**
4	**Mat**	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shqefën	**Bashkia**	**90,499,667**	**39,969,970**
5	**Tropojë**	Rehabilitim i ujëmbledhësit TPLA	**Bashkia**	**32,983,536**	**14,567,467**
TOTALI				**299,993,536**	**132,494,770**